



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit  
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 2144/2019  
Nr.i fqj/Br str./Nr.pg.  
Date/Datum/Date: 16/12/19

PRISHTINË-PRISTINA-PRISTINA



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## LETËR REKOMANDIMI

përkitazi me

vizitën në Qendrën e Korrektuese në Dubravë të Mekanizmit Kombëtar për  
Parandalim të Torturës

Për: **Z. Abelard Tahiri, Ministër**  
**Ministria e Drejtësisë**

**Z. Qemajl Marmullakaj, Sekretar i Përgjithshëm**  
**Ministria e Drejtësisë**

**Z. Uran Ismaili, Ministër**  
**Ministria e Shëndetësisë**

**Z. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm**  
**Ministria e Shëndetësisë**

**Z. Milazim Gjocaj,**  
**Drejtor i Departamentit të Shëndetësisë në Burgje**

**Z. Nehat Thaçi, Drejtor i Përgjithshëm**  
**Shërbimi Korrektues i Kosovës**

**Z. Hivzi Syla, U.d. Drejtor**  
**Qendra Korrektuese në Dubravë**

Prishtinë, më 16 dhjetor 2019

## **Qëllimi i vizitës**

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejmë: MKPT) i Avokatit të Popullit, nga 28 deri më 30 tetor 2019, e ka vizituar Qendrën Korrektuese në Dubravë (në tekstin e mëtejmë: QKD). Qëllimi i vizitës ishte vlerësimi i progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së të dërguara përmes raportit me rekomandime të datës 28 qershor 2018.<sup>1</sup>

### **Bashkëpunimi me MKPT-në gjatë vizitës**

Gjatë vizitës së MKPT-së në QKD, personeli i Shërbimit Korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat e QKD-së. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe iu mundësuan intervistat me personat e dënuar dhe të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues.

### **Keqtrajtimi fizik**

MKPT-ja gjatë vizitës në QKD ka intervistuar një numër të konsiderueshëm të të burgosurve dhe nuk ka marrë ankesa të besueshme për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. Gjatë vizitës është vërejtur komunikim interaktiv dhe miqësor ndërmjet personelit korrektues dhe të burgosurve.

### **Kushtet e akomodimit**

MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se ka pasur rinoime të pavijoneve të caktuara. Në përgjithësi, përveç në pavillonin numër 5 dhe në pavillonin e spitalit, kushtet e akomodimit janë në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP) dhe në pajtim me standartet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (KPT) sa i përket madhësisë së qelive, ndriçimit natyral dhe artificial, përveç në raste të caktuara ku hapësira për banim për një të burgosur nuk është në pajtim me dispozitat e LESP-së dheas me standartet e KPT-së. Sikurse në qendrat e tjera korrektuese dhe të paraburgimit, edhe në QKD ka kohë që nuk ka furnizime të reja me dyshekë cilësorë, të cilët, në përgjithësi janë të dëmtuar dhe, në raste të caktuara, depërton edhe lagështia. MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin veprime konkrete për ta evitar këtë mangësi.

### **Ushqimi**

Gjatë vizitës përcjellëse, MKPT-ja ka marrë një numër të madh ankesash nga të burgosurit lidhur me cilësinë dhe sasinë e ushqimit që u shërbehet. Lidhur me këtë, MKPT-ja, më 11 nëntor 2019, ka kontaktuar me Agjencinë e Ushqimit dhe të Veterinës dhe përmes postës elektronike zyrtare ka kërkuar raportin e fundit të kësaj agjencie për inspektimin në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Edhe pse kjo agjenci konfirmoi se e ka inspektuar kuzhinën në QKD, pavarësisht obligimit për të bashkëpunuar me Institucionin e Avokatit të Popullit, i cili parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Avokatin e Popullit, ky institucion nuk iu përgjigj kërkesës së dërguar.

<sup>1</sup> Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë, publikuar më 28 qershor 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/07/04/raport-me-rekomandime-i-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>

## Kujdesi shëndetësor

Gjatë vizitës, MKPT-ja nuk ka marrë ankesa të besueshme për shkelje të të drejtave të të burgosurve e as për mungesë të kujdesit shëndetësor nga spitali i burgut në QKD. Shërbimet shëndetësore të cilat nuk mund të ofrohen në QKD, ofrohen në institucionet e tjera publike shëndetësore.

## Regjimi

MKPT-ja vërejti se është zbatuar rekomandimi i MKPT-së që të funksionalizohet salla e sportit, i cili rekomandim iu dërgua autoritetevi kompetente përmes raportit me rekomandime të datës 28 qershor 2019. MKPT-ja gjatë vizitës vërejti se funksionalizimi i sallës së sportit tani mundëson aktivitete të shumta sportive për të burgosurit. Të burgosurit aktivitetet sportive mund t'i zhvillojnë edhe në fushën sportive në hapësirë të hapur në oborre.

Gjatë vizitës së fundit, MKPT-ja u njoftua nga drejtori se rreth 344 të burgosur janë të angazhuar në punë me pagesë. Drejtoria ka filluar të angazhojë të burgosurit në punë në rinovimin e pavijoneve dhe në punë të tjera. Gjithashtu, në kuadër të QKD-së funksionojnë tri punëtori, të cilat në fakt janë edhe qendra për trajnime profesionale, ku organizohen trajnime për saldim, për ndërtimtari, për axhustator, për zdrukthëtar, për mirëmbajtje teknike, për instalim të ujit dhe për instalim të rrymës. Në këto punëtori organizohen kurse me kohëzgjatje prej tre muajsh.

Bazuar në ndihmën e ofruar nga OJQ HELP, 10 të burgosurve iu ofrua trajnim profesional për saldim. Në kuadër të Qendrës Korrektyuese në Dubravë funksionon shkolla e mesme ku vijojnë mësimin 44 të dënuar. MKPT-ja ka vërejtur se janë bërë përpjekje për të funksionalizuar njësinë ekonomike, e cila parashihet me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, por pritet miratimi i një udhëzimi administrativ, i cili do ta precizonte punën e kësaj njësie ekonomike.

Regjimi për të paraburgosurit në përgjithësi mbetet i varfér. Angazhimi i tyre në punë apo në ndonjë aktivitet tjetër varet në shumicën e rasteve nga leja e gjykatës kompetente. Në shumicën e rasteve nuk kanë në dispozicion diçka tjetër, përvçe daljes në ajër të pastër dy herë në ditë, shikimit të TV-ve në qelitë e tyre.

## Kontaktet me botën e jashtme

Kontaktet me botën e jashtme mbeten në nivel të kënaqshëm. Në dispozicion të të dënuarve dhe të paraburgosurve janë vizitat familjare dhe telefonatat, si dhe vikendet për të dënuarit të cilat i plotësojnë kriteret.

## Rekomandimet e MKPT-së të dërguara përmes raportit të publikuar më 28 qershor 2018

1. **Të miratohet legjislacioni sekondar për luftimin e korrupzionit, siç parashihet me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.**  
Autoritetet kompetente nuk kanë shënuar progres në zbatimin e këtij rekomandimi të MKPT-së, edhe pse miratimi i legjislacionit sekondar parashihet me LESP.
2. **Të bëhen rinovimet e nevojshme në pavijonin 8.**

Gjatë vizitës përcjellëse, MKPT-ja ka vërejtur se ky rekomandim është zbatuar nga autoritetet kompetente. Pavijoni u rrinova në tërsi dhe shumica dërmuese e punëve janë kryer nga të burgosurit.

### **3. Të furnizohet kuzhina me pajisje adekuate sipas vlerësimit konkret.**

Nuk ka pasur ndonjë progres konkret në zbatimin e këtij rekomandimi. Për më shumë, MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se personeli në kuzhinë nuk kanë uniforma pune. Si zëvendësim për uniforma të punës ata përdornin qese plastike.

### **4. Të ndërmerrin hapa konkretë në mënyrë që të ndërpritet praktika e përdorimit të pajisjeve të improvizuara elektrike.**

Bazuar në takimin me drejtorin dhe në intervistat me të burgosurit, meqenëse ka ujë të ngrohtë, të burgosurit nuk kanë arsyesh përdorin pajisje të tillë. Drejtoria ka kryer një varg kontrolllesh dhe i ka konfiskuar pajisjet e tillë. Kjo u konfirmua edhe përmes intervistave me të burgosurit.

### **5. Të burgosurit të furnizohen me dollapë për vendosjen e gjësendeve të tyre.**

MKPT-ja ka vërejtur se në pavijonet e rrinova dollapët për vendosje të gjësendeve janë të fiksuara në mure të qelive, ndërsa në pavijonet e tjera gjendja në përgjithësi mbetet e njëjtë sikurse ajo e konstatuar gjatë vizitës së mëparshme.

### **6. Të funksionalizohet salla e sportit**

MKPT-ja vërejti se është zbatuar rekomandimi i MKPT-së që të funksionalizohet salla e sportit, i cili rekomandim iu dërgua autoriteteteve kompetente përmes raportit me rekomandime të datës 28 qershor 2019. MKPT-ja gjatë vizitës vërejti se funksionalizimi i sallës së sportit tanë mundëson aktivitete të shumta sportive për të burgosurit. Të burgosurit aktivitetet sportive mund t'i zhvillojnë edhe në fushën sportive në hapësirë të hapur në oborre.

### **7. Të funksionalizohet njësia ekonomike**

MKPT-ja ka vërejtur se janë bërë përpjekje për ta funksionalizuar njësinë ekonomike, e cila parashihet me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, por pritet miratimi i një udhëzimi administrativ, i cili do ta precizonte punën e kësaj njësie ekonomike.

### **8. Në spitalin e burgut të gjendet zgjidhje adekuate për të ofruar qasje adekuate në katin e dytë për pacientët me aftësi të kufizuara**

Lidhur me këtë rekomandim të MKPT-së, drejtori e ka njoftuar MKPT-së se pacientët e tillë do të dërgohen në pavjonin 7 ku ka kushte adekuate, në pajtim me gjendjen e tyre. Kjo gjendje u konstatua nga MKPT-ja gjatë vizitës në këtë pavjon.

### **9. Të angazhohet personeli i nevojshëm korrektues, sipas vlerësimit të nevojave**

Gjatë kësaj periudhe nuk pati angazhim të personelit shtesë korrektues. MKPT-ja konsideron se rekomandimi për angazhim të personelit të nevojshëm korrektues ende nuk është zbatuar nga autoritetet kompetente.

### **10. Të vendosen kamerat e sigurisë aty ku mungojnë**

Gjatë vizitës përcjellëse në Qendrën Korrektuese në Dubravë, MKPT-ja vërejti se në dhomën e kontrollit janë instaluar disa kamera rrotulluese të sigurisë, të cilat marrin imazhe HD, ndërsa kompania e kontraktuar i irregullonte ato të cilat nuk ishin në gjendje funksionale dhe shtonte kamerat e sigurisë aty ku mungojnë.

## **11. Të shtohet numri i punëtorëve socialë, bazuar në numrin e të burgosurve në QKD**

Gjatë vizitave në Qendrën Korrektuese në Dubravë, MKPT-ja ka marrë shqetësimet e drejtorisë dhe të punëtorëve socialë bazuar në numrin e madh të të burgosurve. Përmes raportit me rekomandime për vizitën në këtë qendër, MKPT-ja u ka rekomanduar autoritetevi kompetente që ta shtojnë numrin e punëtorëve socialë, bazuar në numrin e të burgosurve në QKD. Gjatë vizitës së fundit përcjellëse në QKD, MKPT-ja u njoftua se ka pasur tentime për rekrutim shtesë të zyrtarëve socialë, por kanë dështuar procedurat e rekrutimit.

## **12. Të adresohen nevojat e zyrtarëve korrektaus sa u përket kushteve të punës dhe shqetësimeve për statusin e tyre që ndërlidhet me Ligjin për Pagat**

Edhe gjatë kësaj vizite, MKPT-ja ka marrë ankesa nga zyrtarët korrektaus lidhur me statusin e tyre bazuar në Ligjin për Pagat. Drejtori e njoftoi MKPT-në se nuk ka ndonjë informatë konkrete të cilën do ta ndante me personelin korrektaus sa i përket ligjit në fjalë. Gjatë vizitës, MKPT-ja fitoi përshtypjen se shqetësimi i personelit korrektaus bazohet më shumë në mungesën e informatave konkrete lidhur me koeficientet dhe kategorizimin sipas ligjit në fjalë. Shqetësimi tilla MKPT-ja ka marrë edhe nga personeli korrektaus që punojnë në qendrat e tjera korrektause dhe të paraburgimit.

Avokati i Popullit, në pajtim me autorizimet e tij kushtetuese dhe ligjore, më 5 dhjetor 2019, e ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese Ligjin nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, me qëllim të vlerësimit të përputhshmërisë së tij me Kushtetutën.

Avokati i Popullit ka kërkuar edhe vendosjen e masës së përkohshme ndaj zbatimit të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik deri në një vendim përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese, duke vlerësuar se vendoja e masës të përkohshme është e nevojshme për ta mbrojtur interesin publik dhe për të evitar dëme të pariparueshme që do të mund të shkaktoheshin me zbatimin e këtij ligji.

MKPT-ja, edhe gjatë kësaj vizite, ka marrë ankesa nga zyrtarët korrektaus për shkak të moszbatimit të dispozitës së Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, e cila parashev llogaritjen së stazhit të beneficuar.

MKPT-ja vëren se nen 221 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale shprehimisht përcakton: “*Zyrtarët korrektaus, për shkak të rrezikshmërisë, rëndësisë, si dhe kushteve të veçanta të punës, për çdo dymbëdhjetë (12) muaj pune i llogaritet si gjashtëmbëdhjetë (16) muaj stazh i siguruar, kurse në llogaritjen e pagave sigurohet një shtesë e të ardhurave.*”

## **13. Të hiqet nga përdorimi *peper spray* me afat të skaduar**

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka vërejtur se zyrtarët korrektaus posedonin në kuadër të pajisjeve të tyre *peper spray* me afat të skaduar. Përmes raporteve me rekomandime, MKPT-ja u ka rekomanduar autoritetevi kompetente që *peper spray* me afat të skaduar të hiqet nga përdorimi, pasi që mund të ketë efekte shumë të dëmshme nëse përdoret në hapësira të myllura, siç janë burgjet. Përmes vizitave të ndryshme, MKPT-ja u njoftua nga zyrtarët kompetentë se zyrtarët korrektaus janë furnizuari me *peper spray* të ri.

Megjithatë, MKPT-ja, siç ka rekomanduar edhe në raportet e tjera me rekomandime, sërisht thekson se *peper spray* nuk duhet të përbëjë pajisje standarde për të gjithë zyrtarët korrektues.

Në bazë të të gjeturave dhen të konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

## REKOMANDON

Ministrisë së Drejtësisë:

- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të miratohet legjislacioni sekondar për luftimin e korruptionit, siç parashihet me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.
- MKPT ripërsërit rekomandimin që të furnizohet kuzhina me pajisje adekuate sipas vlerësimit konkret.
- Personeli që punon në kuzhinë të furnizohet me uniforma pune.
- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të burgosurit të furnizohen me dollapë për vendosjen e gjësendeve të tyre.
- Të rriten angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit, brenda mundësive të QKD-së dhe në pajtim me legjislacionin relevant në fuqi.
- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të funksionalizohet njësia ekonomike.
- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të angazhohet personeli i nevojshëm korrektues, sipas vlerësimit të nevojave.
- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të shtohet numri i punëtorëve socialë, bazuar në numrin e të burgosurve në QKD.
- Të bëhen renovimet e nevojshme në Pavijonin numër 5 dhe në pavijonin e spitalit në QKD.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkua të pajtim me ligj*") dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshire edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*"), ju lutemi mirësish që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

  
Me nderime,  
Hilmi Jashari

Avokat i Popullit